




GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF
KOSOVO



PËR: GJYKATAT THEMELORE, GJYKATËN E APELIT, ZYRËN E
KRYEPROKURORIT TË SHITETIT DHE PROKURORITË THEMELORE

NGA: GJYKATA SUPREME

Q A R K O R E

**LIDHUR ME MASAT E FSHEHTA DHE TEKNIKE TË VËZHGIMIT DHE
HETIMIT**

ÇËSHTJET E TRAJTUARA ME KËTË QARKORE JANË: Kur këto masa mund të zbatohen, nga kush urdhërohen, statusi i provave të siguruarra nëpërmjet këtyre masave, kur provat janë të papranueshme, kush vendos lidhur me ankesën ndaj vendimit për shpalljen e një prove të papranueshme, statusi i disa provave të siguruarra, jashtë masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit.

MASAT E FSHEHTA dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, mund të jepen para fillimit të procedurës dhe pas fillimit të procedurës.

- 1. PARA FILLIMIT TË PROCEDURËS** së hetuesisë këto masa mund t'i urdhërojë **prokurori** ose **gjyqtari i procedurës paraprake** me kërkesë të prokurorit, d.m.th., në këtë fazë, të gjitha masat nga neni 87 i KPPK, mund të autorizohen nga vet **prokurori** (neni 84.par.1.i KPPK), e që nuk po vërehet se ky mandat ligjor i prokurorëve po shfrytëzohet në praktikë - në punën e tyre, por

çdoherë, po kërkojnë që urdhrin ta jep gjyqtari i procedurës paraprake, sikur mos të ekzistonte kjo dispozitë.

NË KËTË SITUATË, urdhri mund të jepet: kur ekziston dyshimi i bazuar se është kryer; po kryhet; apo së shpejti do të kryhet, ndonjëra nga veprat penale, sipas nenit 90 të këtij Kodi, dhe në këtë fazë nuk është e domosdoshme të dihet identiteti i të dyshuaritve, që do të thotë se urdhër mund të jepet edhe ndaj personit anonim (neni 84 par.2. i KPPK).

NË URDHËR duhet të shënohen të dhënat e personit që vihet nën këto masa, vetëm atëherë kur dihet identiteti i personit të dyshuar, por nëse nuk dihet për identitetin e tij (*pritet kryerja e veprës penale nga dikush*) urdhri jepet për N.N. personin-at dhe provat e siguruara nëpërmjet urdhrin ndaj. N.N personit janë prova, absolutisht të ligjshme.

PAS FILLIMIT TË PROCEDURËS, këto masa mund të autorizohen vetëm me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake(neni 86.par.2), përjashtimisht, në raste urgjente, edhe nga prokurori i shtetit, për disa vepra penale, nëse ky urdhër konfirmohet nga gjyqtari i procedurës paraprake, brenda tri (3) ditësh(neni 91.par.1 të KPPK) .

2. ÇËSHTJA TJETËR DISKUTABILE që kjo Gjykatë ka vënë re lidhur me provat e siguruara nëpërmjet këtyre masave, është kompetenca për të vendosur lidhur me ankesat ndaj vendimeve, me të cilat është vendosur për ligjshmërinë e këtyre provave. Nga praktika e gjertanishme ka vendosur Gjykata e Apelit , mirëpo rezulton se norma ligjore nuk ka mandatuar Gjykatën e Apelit që të vendosë për këto ankimime.

NENI 97 .PARAGRAFI 3. I KPPK, shprehet; Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, vlerëson kundërshtimet e të pandehurit lidhur me pranueshmerinë e provave të mbledhura, nëse kundërshtimet paraqiten para shqyrtimit të dytë. Kundër vendimit mbi kundërshtimin nga ky paragraf, mund të paraqitet ankesë.

NENI 98 PARAGRAFI 2. KPPK, shprehet: Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit përbëhet nga tre gjyqtarë, të cilët emërohen nga kryetari i gjykatës themelore për

të vendosur mbi ankimimin konkret ose kompensimin ndaj aktvendimit konkret, nga neni 97.para. 3. Nga kjo, qartë rezulton se, kur gjyqtari i vetëm apo kryetari i trupit gjykues, një provë e shpallë të paligjshme, lidhur me ankesën vendosë Paneli për Shqyrtimin e Hetimit dhe Vëzhgimit, e jo Gjykata e Apelit, siç po veprohet në praktikën e gjertanishme të gjykatave. Në këto situata, ligjdhënësi ka ndërtuar parimin remonstrativ dhe ka shmangur atë devolutiv, siç ka vepruar edhe në disa situata tjera p.sh., Nenin 201.par.4 , neni 191.par.2.të KPPK.

3. ÇËSHTJA TJETËR DISKUTABILE rezulton të jetë pranueshmëria e provave, siç janë SMS dhe regjistri i numrit të telefonave, me të cilët i pandehuri ka komunikuar, të siguruar jashtë këtyre masave. Edhe SMS edhe regjistri i numrave të telefonave, të mbledhura nga prokuroria ose gjykata, jashtë këtyre masave, janë prova të pranueshme.

PROKURORI SHTETËROR DHE GJYKATA kanë të drejtë të ndërmarrin çdo veprim procedural, për të siguruar prova relevante për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit (për vërtetimin e fakteve relevante). Në mesin e provave tjera mund të kërkojnë edhe mesazhet telefonike, regjistrin e komunikimeve telefonike edhe komunikimet nëpërmjet internetit etj., pa i aplikuar masat e fshehta teknike dhe të vëzhgimit.


MASAT E FSHEHTA TEKNIKE, aplikohen vetëm atëherë kur provat nuk mund të sigurohen në ndonjë mënyrë tjetër, dhe nëse provat janë siguruar nëpërmjet këtyre masave, atëherë procedura duhet respektuar maksimalisht, përndryshe, prova rezulton të jetë e papranueshme.

PROKURORIA – GJYKATAT, sikurse që kanë të drejtë të kërkojnë p.sh., dokumentacionin e kontabilitetit nga një kompani, për të vërtetuar ndonjë fakt, po ashtu kanë të drejtë të kërkojnë mesazhet telefonike që ka shkëmbyer i pandehuri me personat tjerë, për të vërtetuar ndonjë fakt, dhe këto prova janë të ligjshme dhe të pranueshme.

Ju falënderoj për bashkëpunim dhe mirëkuptim.

Me respekt,

Prof.dr. Fejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës